



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1332/2 prot

Datë 29.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Library Dyrrahu” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01610-04-16-2024 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me NUIS J62426002Q, me adresë: Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë, me adresë: Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë.
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, me NUIS L91418502J, me adresë Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe truall 1’000 m2 dhe siperfaqe ndert., Durrës

Në datën 28.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1332/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4127 e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-01610-04-16-2024 me objekt “Blerje kancelari”, me fond limit 1 556 550 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Library Dyrrahu” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Konkretisht në ankesë pretendohet se operatori ekonomik “Library Dyrrahu” SHPK, ka paraqitur ofertë anomalizht të ulët, të paargumentuar.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 29.05.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro